INNOVET ALBANIA BULETIN

Le të kontribuojmë për fuqizimin e komunitetit të AFP-së!

albanianskills
We promote skills

Të dashur lexues,
Jam e nderuar t'ju prezantoj publikimin e dytë të Buletinit INNOVET ALBANIA. Unë ia kam dedikuar karrierën time zhvillimit të aftësive dhe jam e lumtur të shoh se interesi në rritje për to, është materializuar në një buletin të orientuar në trajnimin dhe edukimin profesional, për të gjithë ata që duan të jenë përherë të përditësuar me zhvillimet më të fundit në këtë fushë.
Udhëtimi im me Albanian Skills nisi 5 vite më parë. Prej një bisede të natyrshme me Anën, drejtoreshën ekzekutive të Albanian Skills, dhe një prezantimi të eventeve të mëparshme të Konkurseve të Aftësive, mu shtua kurioziteti dhe dëshira për të kontribuar në këtë kauzë. Ne duhet të jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për rëndësinë që arsimi dhe trajnimet profesionale janë duke fituar në treg. Ndërkohë që niveli i regjistrimit për shkollat e mesme të përgjithshme është në rënie, për shkollat e mesme të arsimit profesional po ndodh e kundërta. Megjithatë, shumë të rinj janë ende hezitues për ta ndërmarrë këtë hap drejt rrugës profesionale të edukimit, nga frika e asaj që mund të jenë duke humbur ose nga ajo e përfundimit në një drejtim zhgënjyes.

Mirëpo, cilado qoftë specifikisht rruga juaj, e kundërta është e vërtetë. Le ti hedhim një sy Bashkimit Evropian, i cili rregullisht ndikon në tregun shqiptar të punës. Për të mos përmendur që pothuajse gjysma e studentëve të shkollave të mesme në BE janë në shkolla të mesme profesionale, edhe perspektiva e punës duket premtuese, duke qenë se punësimi i të diplomuarve në edukimin profesional është më i lartë se punësimi i të diplomuarve që vijnë nga një drejtim i përgjithshëm, me një mesatare të shkallës së punësimit prej 78.1% në vitin 2016. Sigurisht, asnjë nuk pengohet për të qenë i suksesshëm, sikurse në 2018 thuajse gjysma (44.6%) e të diplomuarve në edukimin profesional ishin femra. Nga punët tradicionale të elektriçistëve dhe hidraulikëve te punët më emocionuese të së ardhmes, qofshin këto në Teknologji Informacioni apo Inteligjencë Artificiale, ka shumë për të fituar nëse ju investoni në të ardhmen profesionale. **Kini guxim të hidhni hapin!**

Dorina Islami,
Anëtare e Bordit Ekzekutiv të Albanian Skills - National Association for Skills Competitions dhe bashëpunëtore për zinxhirin e eventeve të Javës së Aftësive

Rubrikat e Innovet Albania - Publikimi i Dytë

Ky publikim u përgatit dhe u editua nga: Orjeta Ramaj & Fatma Memalli

Arsimi dhe Formimi Profesional nga këndvështrimi i studentëve të AFP

Disa fjalë nga Nebjon Kashari, nxënës i Shkollës Profesionale "Hasan D. Gina", Lushnjë dhe Kristi Tako, nxënës i Shkollës Profesionale "Isuf Gjata", Korçë.

Njoftimi i Javës së Aftësive Shqiptare 2021

Ne jemi te lumtur dhe krenarë të shpallim për të katërtin vit rradhazi organizimin e Javës së Aftësive në Shqipëri, nga 24 maj deri më 30 maj 2021.

Intervistë me Znj. Flutura Xhabiaj, themeluese e shoqatës SHGPAZ

"Përvoja është shkencë". Është meritë e një kombi të nxisë atë çfarë di më shumë dhe ta mbështesë.

INTERVET WESTERN BALKANS - Një mundësi e shkëlqyer për arsimin dhe trajnimin profesional.

Në muajin Nëntor, Projekti INTERVET WB hapi thirrjen e parë të mobilitetit mësimor për nxënësit e shkollave të Arsimit Profesional, me destinacionin e parë në Forlì.

CoffeeTalk, një traditë e përmuajshme që sjell më pranë komunitetin e AFP-së!

Arsimi Profesional numëron arritje të shumta dhe problematika që kanë nevojë për zë për t'u dëgjuar. "CoffeeTalk" është vendtakimi i një larmishmërie idesh e diskutimesh dhe një spektri të gjerë përvojash.

Albanian Skills Intern

Testimonial nga Beti Lika & Odeta Kurti

ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL NGA KËNDVËSHTRIMI I STUDENTËVE TË AFP-SË

Disa fjalë nga Nebjon Kashari, nxënës i Shkollës Profesionale "Hasan D. Gina", Lushnjë,

Kur dëgjova se Albanian Skills do të krijonte një buletin mujor mbi inovacionin në arsimin dhe formimin profesional, dhe ne mund të jipnim kontributin tonë në të, u gëzova, pasi jam i bindur që secili prej nesh ka shumë për të thënë mbi arsimin profesional, avantazhet dhe disavantazhet e tij, aftësitë që i duhen secilit prej nesh, inovacionin etj. Unë jam një nxënës në shkollën profesionale Hasan D. Gina në Lushnjë, aktualisht në vitin e dytë për degën Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.

Do të doja ta nisja mendimin tim bazuar në një opinion të përgjithshëm për gjendjen në shkollat profesionale, e cila lë për të dëshiruar. Shumica e nxënësve, pasi mbarojnë klasën e 9-të janë në dilemë për zgjedhjen e tyre dhe vijimin e shkollës së mesme, duke qendruar kështu midis shkollave të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe shkollave të arsimit profesional. Nxënësit ekselentë, rrallëherë ndodh të mendojnë për të vazhduar edukimin e tyre në një shkollë të arsimit profesional, e megjithatë kohët e fundit ky opinion i krijuar ka ndryshuar.

Një nga arsyet më të rëndësishme që ata kanë parasysh kur marrin këtë vendim janë problematikat e mëdha në mungesën e materialeve të punës që nevojiten për kryerjen e praktikës në shkollat profesionale....Por në realitet, unë do të thoja se një nga përparësitë që shkollat profesionale kanë në raport me gjimnazet e përgjithshme, është që kur mbaron 4 vitet e edukimit profesional, nxënësi pajiset me dy diploma shumë të vlefshme, siç janë ajo e gjimnazit dhe diploma e profesionit. Të dyja këto të mësipërmet, janë një vlerë e shtuar për të ardhmen e tij.

Unë, si nxënës i arsimit profesional jam i kënaqur me mundësitë që kjo shkollë të ofron për të patur një të ardhme sa më të sigurt dhe një profesion që dua të zhvilloj më tej përgjatë rrugëtimit tim.
Nëse do të më pyesnin për aspektet që kanë nevojë për përmirësim në shkollën time do të thoja "Infrastruktura", duke nënkuptuar herë gjendjen jo të mirë të mjeteve të punës dhe herë mungesën e disa materialeve në shkollë. Në rastin e degës së studimeve të mia, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, kërkon një anagzhim të madh praktik me mjete kompjuterike. Në këtë rast, kompjuterët që shkolla disponon nuk janë të mjaftueshëm dhe janë në një gjendje jo shumë të përparuar. Kjo ndikon drejtpërdrejt në mësimnxënie sepse pavarësisht shpjegimit shumë të mirë dhe materialeve mësimore të bollshme që ne marrim nga mësuesit tanë, nëse infrastruktura është e pamjaftueshme, kjo do të bëjë që edhe rezultati të mos jetë i duhuri e ne të mos arrijmë të mësojmë ashtu si duhet.
Megjithatë, dëshiroj t'i lë mënjanë problematikat dhe të shoh anën pozitive të arsimit professional. Dëshira dhe pasioni janë në mendimin tim dy nga shtyllat kryesore që e shtyjnë një nxënës të bëhet i mirë në profesonin që ka zgjedhur të studiojë. Nëse këto të dyja janë pjesë e tij, ky i fundit mund të mposhtë të gjitha problematikat që ka shkolla dhe të arrijë suksese të mëdha!!!

Një aktivitet shtesë që na ndihmon në arritjen e suksesit dhe përmirësimin e aftësive tona, janë edhe konkurset që zhvillohen nga organizata të ndryshme apo edhe projekte që ofrojnë mundësi për të rinjtë, si rasti i projektit "INTERVET WESTERN BALKANS ", i cili implementohet në Shqipëri nga Albanian Skills dhe që mundëson një përvojë dhe një eksperiencë të veçantë në formimin profesional të një nxënësi përmes praktikave profesionale në vende të ndryshme Evropiane. Personalisht, kam marrë pjesë në konkurse të ndryshme që janë zvilluar si në shkollë dhe jashtë saj dhe kam fituar aftësi dhe eksperienca që besoj se do të jenë shumë të vlefshme për të ardhmen time!

Disa fjalë nga Kristi Tako, nxënës i Shkollës Profesionale "Isuf Gjata ", Korçë,

Orët intesive të praktikës në shkollë si dhe bashkëpunimi me biznese të konsoliduara në qytetin tim më kanë dhënë mundësi që të fitoj çdo ditë aftësi të reja.

Shkolla e mesme profesionale "Isuf Gjata" në qytetin e Korçës tashmë është e konfirmuar si shkolla që përgatit specialistë të mesëm të kualifikuar në disa fusha. Më e rëndësishmja dhe e veçanta për mua është ajo e Hoteleri-Turizmit. Në këtë shkollë unë kam gjetur një mjedis miqësor, bashkëpunues, nxitës dhe motivues. Mësimdhënia dhe të nxënit në shkollën tonë mbështetet në kurrikulën që bazohet në formimin e përgjithshëm, në krijimin e personalitetit, në zhvillimin e aftësive profesionale teorike dhe praktike.

Zgjedhja ime në këtë shkollë ishte drejtimi hoteleri- turizëm sepse më pëlqen kuzhina. Kombinimi i shijeve, ngjyrave dhe formave në një pjatë janë sa inspiruese dhe intriguese. Orët intesive të praktikës në shkollë si dhe bashkëpunimi me biznese të konsoliduara në qytetin tim më kanë dhënë mundësi që të fitoj çdo ditë aftësi të reja.

Tani unë e di që çelësi i suksesit tim është profesioni që dua të bëj.

INTERVET WESTERN BALKANS - NJË MUNDËSI E SHKËLQYER PËR ARSIMIN DHE TRAJNIMIN PROFESIONAL

Raport nga Ekipi i Albanian Skills

7 Destinacionet e Mobiliteteve:
- Italì
- Spanjë
- Poloni
- Slloveni
- Francë
- Maltë
- Hollandë

Në muajin Tetor të vitit që lamë pas, Projekti INTERVET WB hapi thirrjen e parë të mobilitetit mësimor për nxënësit e shkollave të Arsimit Profesional, me destinacionin e parë në Forlì, Italì. Thirrja u mbyll në datën 19 Nëntor të vitit 2020 dhe zgjati për rreth 1 muaj. Përgjatë gjithë kësaj kohe pati një interes të lartë që u konkretizua me regjistrimin e 23 shkollave të arsimit profesional në të gjithë vendin dhe aplikimin në total të 35 nxënësve në fushën e IT, Elektroteknikës, Turizmit dhe Ndërtimit. Dhjetë nxënësit e përzgjedhur pritet të kryejnë praktikën 1-mujore në qershor të këtij viti. (*Dëshminë e dy prej nxënësve fitues do ta gjeni në linkun https://youtu.be/7SsvfONRs2s*) .

Në kuadër të këtij mobiliteti studentor, roli i AlbanianSkills si një urë lidhëse mes shkollave të arsimit profesional, institucioneve përgjegjëse të AFP-së në Shqipëri dhe vetë projektit INTERVET WB, në statusin e "organizatës dërguese", përfshiu realizimin e susksesshëm të përgjegjësive të mëposhtme:

- Promovimi i projektit INTERVET WB dhe shpërndarja e informacionit të nevojshëm në të gjitha hallkat e përfshira në këtë thirrje.
- Krijimi i grupeve online me nxënësit, për të qenë sa më pranë nevojave të tyre dhe komunikimi i herëpashershëm me ta.
- Asistencë dhe mbështetje në të gjitha procedurat e nevojshme të regjistrimit.
- Përditësimi i vazhdueshëm në lidhje me vijueshmërinë e projektit, duke marrë parasysh ndikimin që pandemia pati në këtë thirrje.

Sfidat dhe vështirësitë që u hasën lidhen më tepër me çështje teknike si aksesushmëria e internetit në disa zona të Shqipërisë, mungesa e disa prej dokumentave të nevojshshme për disa nxënës (ID, pasaporta), vështirësitë me gjuhën angleze dhe mungesa e përvojës së mëparshme në procedura të ngjashme aplikimi.

COFFEE TALK, NJË TRADITË E PËRMUAJSHME QË SJELL MË PRANË KOMUNITETIN E AFP-SË!



Tradita e takimeve të përmuajshme të pasdites "Coffee Talk" startoi me fillimin e vitit të ri shkollor në Shtator 2020. Përmes këtyre takimeve të përmuajshme synohet të ndërtohet dhe frymëzohet një komunitet AFP-je gjithëpërfshirës, në një klimë ndërvepruese e bashkëpunuese, me përfshirjen e aktorëve nga shkollat AFP, organizatat, institucionet e arsimit profesional dhe vetë sektorit privat. Si çdo fushë tjetër, edhe arsimi profesional numëron arritje të shumta dhe problematika që kanë nevojë për zë për t'u dëgjuar. "Coffee Talk" është vendtakimi i një larmishmërie idesh e diskutimesh dhe një spektri të gjerë përvojash. Ashtu si çdo nisëm e re, edhe Coffee Talk është rritur dhe zhvilluar takim pas takimi.

Ekperienca e Shkollës "Ali Myftiu" për krijimin e një mjedisi krijues dhe bashkëpunues me nxënësit gjatë mësimit dhe jashtë tij, historia e suksesit të "kopshtaqeve" nga Shkolla Bujqësore "Mihal Shahini", modeli i suksesshëm që Shkolla "Isuf Gjata" ka ndjekur për zhvillimin e praktikave profesionale të nxënësve dhe gjurmimin e tyre pas mbarimit të praktikave, me qëllim pasurimin e kurrikulave në përputhje me nevojat e bizneseve pritëse, përvoja e Elite Travel Group dhe këndvështrimi i sektorit privat në marrëdhënie me shkollat VET, kanë qenë disa nga tematikat kryesore të trajtuara gjerësisht përgjatë këtyre 5 muajve. Coffee Talk përforcon edhe një herë mesazhin e fuqishëm të vlerës së komunikimit dhe bashkëpunimit për të ecur në një rrugë të përbashkët. Ashtu sikurse citon dhe Hellen Keller, një autore e mirënjohur amerikane e gjysmëfillimit të shekullit të kaluar, përvoja e veçantë e Coffee Talk na mëson se "***Secili prej nesh mund të bëjë pak, por të gjithë ne të bashkuar mundemi të bëjmë shumë!*** Tashmë, në kalendarin e aktiviteteve të përmuajshme, Coffee Talk është një pasdite e veçantë që nuk duhet humbur! **Bashkohuni me ne më 18 Shkurt 2021, ora 17:00 në Coffee Talk 6!**

"PËRVOJA ËSHTË SHKENCË". ËSHTË MERITË E NJË KOMBI TË NXISË ATË ÇFARË DI MË SHUMË DHE TA MBËSHTESË.

Intervistë me Znj. Flutura Xhabiaj, themeluese e shoqatës SHGPAZ

Znj. Flutura, a mund të bëni një përshkrim të shkurtër të vetes dhe shoqatës tuaj për të gjithë lexuesit?

Të dashur lexues,

Unë jam Flutura Xhabija. themeluese e Shoqatës Kombëtare të Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare. Ia kam dedikuar gjithë jetën sipërmarrjes, jo vetëm për të krijuar institutin tim privat, por edhe për të mbështetur gra të tjera në sipërmarrjet e tyre.

Në vitin 1991, kam krijuar Institutin Privat të Përkthimeve "Flutura & Sons" dhe tashmë, në ditët e sotme kam stabilizuar emrin tim. Megjithatë, ky rrugëtim ka qenë po aq sa frytdhënës dhe i bukur, edhe tepër i vështirë e plot sfida. Vitet '90 ishin vitet që nisa këtë rrugëtim dhe kjo periudhë ka qenë një dramë e madhe për shoqërinë tonë. Ato vite kanë qenë pa frikë vite ku njerëzit ishin në luftë për mbijetesë. Çdo gjë nisi nga fillimi dhe fillimi im ishte plot sfida. E nisa në një tezgë afër gjykatës dhe fillova të zhvillohesha dalëngadalë. Sot, jam e lumtur dhe zgjedhja e së mesmes së artë ka qenë lumturia ime.

2. Pse krijuat pikërisht një shoqatë për gratë? Si ka qenë puna me to dhe a ka ndikuar kjo punë në aftësitë e tyre?

Në vitin 1992 themelova Shoqatën Kombëtare të Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare. E ndërtova shoqatën sepse kuptova që ekonomia është e para. Ekonomia nuk nënkupton vetëm paranë, por punën në vetvete. Shoqëria jonë ka sakrifikuar dy breza dhe ndër këto breza, shumë gra e vajza e kanë humbur qëllimin e tyre. Synimi im ka qenë jo vetëm fuqizimi i gjinisë femërore, por zhvillimi i tyre personal dhe profesional, duke ju afruar sa më tepër civilizimit qytetar. Civilizimi është përvojë jete e kjo shpesh do të thotë të mos kalosh nga e njëjta rrugë dy herë. Shoqëria civile duhet t'ja dedikojë kohën e lirë njerëzve dhe përmirësimit të mirëqenies së tyre në një formë apo në një tjetër. Zhvillimi i shoqërisë civile në vetvete është kontributi i gjithsecilit e jo vetëm i liderit.
Ne si shoqata SHGPAZ, kemi zhvilluar një sërë shërbimesh për mbështetjen dhe inkurajimin e grave shqiptare në biznes përmes informimit, trajnimeve, konferencacve, forumeve, vizitave brenda dhe jashtë vendit, duke u bërë pjesë e një rrjeti të madh organizatash kombëtare e ndërkombëtare.

3. Cilat janë disa nga aftësitë që do të veçonit për të ardhmen e të rinjve, qofshin këto femra apo meshkuj?

Profesionet dhe zanatet duhet të jenë në krye të çdo politike ekonomike dhe sociale. Vendi ynë është një vend i vogël i drejtuar kryesisht nga turizmi, blegtoria dhe bujqësia. Nuk kemi industri të mëdha. Tentuam më parë t'i bënim të gjitha dhe dështuam, prandaj sot duhen nxitur ato fusha në të cilat kemi patur vijimësi. Në vendin tonë duhet nxitur artizanati për një sërë arsyesh. Industritë e rënda po bien dhe artizanati na mundëson rikthimin tek traditat, zhvillimin e turizmit dhe inovacionin, duke i kthyer burimet në produktivitet, në të mirë të njerëzve. Më kujtohet një artikull rreth vizitës së Sekretarit të Shtetit Amerikan, John Kerry, në një fshat të vogël në Peru, ku përmendej se 20% e GDP-së këtij vendi vinte vetëm nga artizanati. Dizajni ynë gjithashtu ka shumë potencial, por duke mos investuar në të, po na e marrin të tjerët. Kam takuar njëherë një vajzë shqiptare që punonte në një këpucari brenda Aeroportit të Heathrow, në Londër dhe talenti i saj ishte i jashtëzakonshëm. Për ta përmbyllur mendoj se duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi artizanatit në tërësi.

4. Çfarë është për ju inovacioni? Dy fjalë për inovacionin? Cfarë do të kontribuonte më së shumti në zhvillimin e aftësive inovative?

Ndonjëherë, fjala inovacion tingëllon si diçka e madhe por shpesh atë e hasim kudo. Inovacioni nuk është gjë tjetër veçse zbatimi i një shpikjeje në përvojën e përditshme dhe nënkupton zhvillimin e intuitës së punës nga gjithësecili prej nesh. Inovacionin mund ta gjejmë në çdo fushë. Edhe një ndryshim apo përmirësim sado i vogël në një produkt apo shërbim, quhet inovacion. Pra, gjithçka e re që ne mësojmë dhe zbatojmë do të kontribuonte në inovacion, qoftë ky për ne, vendin e punës apo shoqërinë në tërësi.
Nxitja drejt inovacionit kërkon ekspertë dhe mbi të gjitha motivim. Motivimi përkthehet në dashuri për zanatin dhe punën. Duhet t'i injektojmë të rinjve dashurinë për punën. Një shprehje italiane thotë "Përvoja është shkencë". Është meritë e një kombi të nxisë atë çfarë di më shumë dhe ta mbështesë.

5. Një mesazh inkurajues për të rinjtë?

Periudha e adoleshencës është një periudhë shumë e vështirë, e ngjashme me shembullin e Odisesë në përpjekje për të kaluar ishullin. Adoleshenca është një "periudhë sirenash". Çdo gjë nis nga edukimi i hershëm në familje. Të rinjve duhet t'u japim shembujt më të mirë pasi shoqëria futet aty ku nuk ka forcë familja. Gjithashtu, bashkëpunimi mes të rinjve është themelor. Duhet të bashkëpunoni, të zhvilloheni që të mos e humbisni potencialin. Duhet t'u mëshojmë fort vlerave dhe jo zilisë. Zilia është problemi që na ka penguar të ecim përpara. **Duhet të keni guxim qytetar, të mos e ulni kokën dhe të luftoni për atë që doni për veten dhe për të tjerët!**

6. Cili do të ishte mesazhi juaj për lexuesit e buletinit?

Mesazhi im për lexuesit e buletinit është një shprehje e Naim Frashërit "Punë, punë natë e ditë që të shohim pakëz dritë". Vetëm puna dhe arsimimi mund të na bëjnë të ecim përpara dhe jo dembelizmi shekullor. Duhet respektuar vetja dhe të tjerët. Të respektohet dija e tjetrit, pasi jeta është me nivele dhe një ditë do t'i vijë rradha gjithësecilit. Çdo skllav ëndërron që një ditë të bëhet zotëri. Ç'do të bësh kur të vijë rradha jote?

Për ta përmbledhur, **ne duhet të jemi të vërtetë, të vërtetë me veten dhe shoqërinë që na rrethon!!**

TESTIMONIALS CORNER - PROGRAMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE@AS

Dy fjalë nga praktikantet e **ALBANIAN SKILLS**

Pas mbarimit të studimeve, kam bërë kërkime për mënyra të ndryshme se si të zhvilloja karrieren time. Ky internship më ka futur në një rrugë që as vetë nuk e dija se kisha nevojë, më ka përmirësuar në aftësi të panumërta.

Albanian Skills më dha mundësinë të kuptoj potencialin tim të mprehtë të dijeve të mia.

Nga Beti Lika

'Fuqia e vajzave', siç Ana na thotë. Ishte një ekip pune vajzash i mrekullueshëm dhe eksperienca ime përgjatë këtyre 3 muajve ishte një vlerë e shtuar për zhvillimin tim personal dhe të aftësive të reja në fushën e marketingut.

Jam shumë e kënaqur që isha pjesë e ekipit të Albanian Skills, pasi gjeta një ambjent pune të ngrohtë e motivues.

Nga Odeta Kurti

Njoftimi i Javës së Aftësive Shqiptare 2021

Ne jemi te lumtur dhe krenarë të shpallim për të katërtin vit me rradhë organizimin e Javës së Aftësive në Shqipëri, nga **24 deri më 30 Maj 2021.**

Java e Aftësive është një iniciativë unike e Aftësive Shqiptare e frymëzuar dhe mbajtur çdo vit në kuadër të aktiviteteve të Javës Evropiane të Aftësive Profesionale, një iniciativë e Komisionit Evropian që synon bërjen e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP) për aftësi dhe punë cilësore, më tërheqëse përmes një kombinimi të ngjarjeve që ndodhin në të gjithë Evropën, në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Java e Aftësive Shqiptare 2021, do të jetë një Festival i Aftësive i organizuar nga nxënës dhe kursantë të AFP-së në Shqipëri. **Mbajeni në mendje dhe bashkohuni me ne gjatë këtij udhëtimi emocionues !!!**

Na ndqini në rrjetet tona sociale - AlbanianSkills

Website: www.albanianskills.org **Social Media: AlbanianSkills** **E-mail: albanianskills@gmail.com**